Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 10/17
Datë/Datum 27-01-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**10/17**
PËR:	Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Suharekës** Parashtruesit të ankesës: **"Diti-Soni & Shpejtimi"** me seli në Suharekë
CC:	Panelit Shqyrtues në OSHP, Arkivës në OSHP
NGA:	Burim Guri - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **"Diti-Soni & Shpejtimi" – Suharekë"**, me numër protokollit: **10/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Transporti i nxënësve – pjesë për vitin shkollor 2016/2017" Lot 3,** me nr. të prokurimit: **624/16/112/221**, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK)– **Komunës së Suharekës.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**27.01.2017**
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Transporti i nxënësve – pjesë për vitin shkollor 2016/2017" Lot 3,** me nr. të prokurimit: **624/16/112/221**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Suharekës,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Diti-Soni & Shpejtimi"** me seli në Suharekë, me numër protokollit: **10/17.**

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		17.01.2017		**19.01.2017**		**27.01.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Më datën 11.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE: **"Diti-Soni & Shpejtimi"** me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Transporti i nxënësve – pjesë për vitin shkollor 2016/2017" Lot 3,** me nr. të prokurimit: **624/16/112/221,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK) – **Komuna e Suharekës.**
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109, - Operatoret Ekonomik Ankues: "Diti-Soni & Shpejtimi" me seli në Suharekë

Pikat e Ankesës:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
Neni 60 Kriteret për dhënie të kontratës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me datë 27.12.2016, kemi pranuar letrën standarde të tenderuesit të eliminuar dhe në arsyetimin tuaj, ju deklaroheni se ju tash keni nënshkruar kontratë dhe keni deklaruar se ne nuk mundemi me i transportua në të njëjtën kohë nxënësit me mjete të njëjta të transportit në realicione të ndryshme dhe sipas jush qenka në pajtim me FTD e cila qartë ka specifikuar se OE mund të jetë fitues në maksimum 1 LOT.

Deklarata dhe faktet:

Në këtë tender që e keni shpallur si Komunë e keni ndarë në 2 LOTE:
Njoftimi për kontratë pika: II.1.10.

II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Përshkrimi i shkurtër
Lot 1	Segmenti rrugor: Breshancë, Bullak, Brahaj, Perzhak, Hasanaj, Prrojak, Demaj, Sejdak deri te shkolla e Nishorit dhe anasjelltas. –Vija që duhet të përshkoj nëpër këto lagje vajtje-ardhje në një ndërrime është deri në 15 km, gjithsejtë janë 170 nxënës. Sqarim: (mësimi nga gjysmë vjetori i dytë fillon me një ndërrim)

Lot 2	Segmenti rrugor: Vershec, Starvuqin, Dardhisht e poshtme, Lagjja e Kokollarëve (Sherif Islamit), -Lagja Vrella (Qadrak) deri te shkolla e Mohlanit dhe anasjelltas. Vija që duhet të përshkoj vajtje-ardhje 48 km, gjithsej janë 79 nxënës.

Shih procesverbalin e hapjes ku ne kemi ofertua vetëm në një LOT.

Është për të çudit fakti kur deklaroni se sipas dosjes së tenderit pikës 2.3 se OE mund të jetë fitues i vetëm një LOTI.
Ne nuk jemi në dijeni se në cilin lot na keni shpërblyer me kontrate në këtë aktivitet të shpallur me datë: 01.12.2016, kur njërin **Lot e keni anuluar dhe tjetrin – lotin 3 e keni shpërblyer me kontratë OE Diana.**
Me këtë rast ju keni shkelur rënd nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, sepse nuk na keni trajtuar në mënyrë të barabartë pasi që edhe jemi me çmim më të lirë se OE i shpërblyer me kontratë.

Sa i përket arsyetimin tuaj, në momentin e tërheqjes së dosjes së tenderit nga ju nuk kemi marruar asnjë informacion se neve na mohet e drejta për të konkurruar në këtë tender, sepse ne e paskemi një kontratë të ngjashme me juve si AK. Dhe është e vërtet se ne kemi një kontratë me AK, por ajo kontratë është e një tenderi krejt tjetër i cili është shpall edhe është përfunduar që një kohë.

Në këtë rast siç e ceka edhe më lart, ju keni bërë diskriminim të hapur ndaj OE-ve, dhe në këtë mënyrë keni kufizuar pjesëmarrjen në tender, dhe njëkosisht na keni krijuar shpenzime të qëllimshme vetëm e vetëm për të na dëmtuar.

Si shkelje tjetër nga ju si AK, konstatohet se është bërë shkelje e nenit 59 dhe 60 të po këtij ligji, pra të Ligjit të Prokurimit Publik, sepse ekzaminimi vlerësimi i ofertës bëhet sipas kërkesave të dosjes, dhe jo në bazë të preferencave dhe me këtë rast ju keni shkelur edhe nenin 60 sepse kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Krejt në fund kërkoj nga ju që të aprovoni ankesën sepse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik të plotësuar dhe ndryshuar, dhe po ashtu edhe me vet kërkesat dhe sqarimin dhe në pikën 2.3 sepse ne në këtë tender nuk jemi shpërblyer me kontratë, por në një tender tjetër, pra nuk ka të bëjë fare me tenderin e datës: 01.12.2016 dhe se AK nuk ka kërkuar në asnjë pikë të dosjes së tenderit mjete shtesë për lote veç e veç dhe megjithatë ne jemi konkurrent në vetëm një LOT. Pra ne kemi ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, jemi me çmim më të lirë dhe NUK MUND TË NA ELIMINON AK. SEPSE KEMI NJË KONTRATË NË NJË AKTIVITET TJETËR.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:	01.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbim/Vlerë e Mesme
Vlera e parashikuar e kontratës:	Lot.3. 8,960.00 Euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	13.12.2016
Data e hapjes së ofertave:	13.12.2016
Data e njoftimit për dhënie të kontratës në KRPP:	23.12.2016

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim , qe tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë ne pajtim me Ligjin Nr04L-042

2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime/borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës

3. Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)

2. Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne ëeb faqen e ATK-se).

3. Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar)

Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken 2 dhe 3 i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim te ofertës dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje)

2.Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje)

3. Çertifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)

4. **Licensa nga institucionet përkatëse se OE kane të drejtë të merren me ketë llojë vepritarie**

Dështmia e kërkuar dokumentare:

1.Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje).

2.Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje).

3.Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje).

4. Kopja e Licenses

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1.Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2013,2014,2015) ka qenë prej jo më pak se:

Per Lot/Pjesa 1= 20,000.00 Euro

Per Lot/Pjesa 3= 6,000,00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Dokument nga banka për qarkullimin e OE në tri vitet e fundit 2013,2014,2015, ose pasqyrat e auditura financiare për tri vitet e fundit 2013,2014,2015 ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK per vitet 2013,2014,2015).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (së paku një)

2.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion mjete-paisje në disponim-pronësi ose të marruara me qira për realizimin e shërbimeve të transportit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Të paraqitet lista e sherbimeve të ngjajshme të realizuar në tri vitet e fundit (2013,2014,2015) e vërtetuar nga Operatori Ekonomik, ku përfshihen titujt e sherbimeve si dhe dëshmi referenca.

2. Listën e mjetet-paisjeve të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave valide të qarkullimit mbi pronësinë e tyre, ose kontrata mbi qiramarrjen (listës t'i bashkëngjiten kopjet e dëshmive: librezat e qarkullimit me fotografi) e vërtetuar nga Operatori Ekonomik.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	N.P.T. "Diana".	Suharekë	8,951.60 €
2.	"Diti-Soni & Shpejtimi"	Suharekë	7,268.00 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë vetëm përfaqësuesi i OE ankues, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

1. Kryesuesi i komisionit: Avni Tafolli - Ekonomist
2. Anëtar i komisionit: Ukë Thaqi - Prof.i pedagogjisë
3. Anëtar i komisionit: Ahmet Emërllahu

Data e fillimit dhe data e mbarimit të ri-vlerësimit:.....23.12.2016-23.12.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....23.12.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Deklaratë:

Komisioni pas vlerësimit të OE konstatoi se OE "Diana" nga Suhareka ishte më i kompletuar në Lot-3 dhe rekomandon zyrtarin e prokurimit që OE "Diana"- Suharekë të shpallet fitues për Lot-3 me çmim 8,951.60€.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1: Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Suharekës** me aktivitetin e prokurimit: **"Transporti i nxënësve – pjesë për vitin shkollor 2016/2017" Lot 3,** me nr. të prokurimit: **624/16/112/221**, ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike në vlerë të mesme.

Operatori ekonomik ankues: **"Diti-Soni & Shpejtimi"** me datë:30.12.2016, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK për këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënie të kontratës me pretendimet ankimore se është bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe atë të nenit: 7,59 dhe 60 të LPP-së në fuqi.

AK- Komuna e Suharekës me datën 04.01.2017, ka kthyer përgjigjeje ndaj operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Arsyetimi:
"Autoriteti kontraktues gjatë shqyrtimit ka rikonfirmuar se OE "Diti-Soni & Shpejtimi" i mungojnë kapacitetet siç janë kërkuar me dosje në FTD pika 9.1.2. 9.2.2. Bazuar në vlerësimet që ka bërë Autoriteti Kontraktues është specifikuar se OE kanë kapacitetet për të shpërblyer vetëm për një LOT/Pjesë dhe në FTD ka specifikuar qartë se OE mundë të shpërblehet vetëm me një Lot/Pjesë".

OE ankues për të njëjtin aktivitet të prokurimit ju ka drejtuar OSHP-së me ankesë me datë: 11.01.2017, kundër OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Sqarimi 2: Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-së.
Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues ka respektuar nenin 59 të LPP-së, që ka të bëj me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, si dhe ka respektuar kërkesat të përcaktuar në dosjen e tenderit, dhe pretendimet ankimore i kualifikon si të pa bazuar.

Sqarimi 3: Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të neneve sipas LPP-së, dhe ku citohet nga OE ankues se:
"Me datë 27.12.2016, kemi pranuar letrën standarde të tenderuesit të eliminuar dhe në arsyetimin tuaj, ju deklaroheni se ju tash keni nënshkruar kontratë dhe keni deklaruar se ne nuk mundemi me i transportua në të njëjtën kohë nxënësit me mjete të njëjta të transportit në realicione të ndryshme dhe sipas jush qenka në pajtim me FTD e cila qartë ka specifikuar se OE mund të jetë fitues në maksimum 1 LOT".

Eksperti shqyrtues sqaron se gjatë ekzaminimit të shkresave të ofruar, Autoriteti Kontraktues ka respektuar nenin **27/A, (Ndarja e Kontratave në Lote)**, dhe gjithashtu ka respektuar kriterin që ka kërkuar në dosjen e tenderit, që lidhën me nenin 27/A.
AK tek pozicioni 2.3 të FDT-së, ka kërkuar, ku citohet: *"Numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: Një (1) LOT/Pjesë",*
Ndërsa, AK për faktin ka sjellë kontratën e nënshkruar me datë: 02.12.2016, për Lotin/Pjesën 4, me OE **"Diti-Soni & Shpejtimi"**, dhe pretendimet ankimore të OE ankues kualifikon si të bazuara.

Mund të shihni edhe arhivën e KRPP-së të publikuar me datë: 23.11.2016 njoftimin për dhënie të kontratës, ku shihet që OE ankues **"Diti-Soni & Shpejtimi"**, është fitues për Lotin/Pjesën 4, në vlerë prej: 17,296.00 €.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit: **"Transporti i nxënësve – pjesë për vitin shkollor 2016/2017" Lot 3,** me nr. të prokurimit: **624/16/112/221**, i rekomandoj panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuara, ndërsa Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme.